



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

---

Numri i lëndës: 2021:156562

Datë: 17.05.2024

Numri i dokumentit: 05701299

**C.nr.688/2021**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN-Departamenti i Përgjithshëm**, në përbërje prej gjyqtarit Zenel Tasholli, gjyqtar individual, në çështjen juridike kontestimore të paditëses N. F.. nga P... të cilen me autorizim e përfaqëson Egzona Gashi av nga Lipjani, kundër të paditurës Komuna e Lipjanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Lipjan, me objekt kontesti kompensim i të ardhurave në bazë të inflacionit, jashtë seance gjyqësore, me dt.15.05.2024 merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**PA SHQYRTIM KRYESOR TË ÇËSHTJES**

**I.APROVOHET** në tërsi kërkesëpadia e paditëses N..F..nga P... si e bazuar.

**II. DETYROHET** e paditura Komuna e Lipjanit– Drejtoria e Arsimit, që paditëses t’ia paguaj në emër të shpenzimeve të ushqimit për periudhën nga dt.11.03.2019-21.11.2022 për 604 ditë pune aktive shumë prej **1,008€**, në emër të shpenzimeve të udhëtimit në relacionin Konjuh-Lipjan për periudhën nga dt.10.03.2020-21.11.2022 për 331 ditë pune shumë prej **231.70€**, në emër të inflacionit shtesën në pagën bazë për periudhën nga dt.10.05.2020-21.11.2022 shumë prej **715.70€** dhe në emër të kualifikimit diferencën shtesë në pagë bazë prej 27% për periudhën nga dt.11.03.2019-01.02.2023 nga 55.32€ për çdo muaj – për 47 muaj shumë e përgjithëshme prej **2,601.45**, të gjitha këto shuma me kamatë prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë dt.15.07.2021 e deri në përmbushjen definitive të detyrimit të gjitha këto në afatin prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

**III. DETYROHET** e paditura që paditësit t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 238.00.€

## A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuares së saj, në këtë gjykatë ka parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Lipjanit – Drejtoria e Arsimit, sipas bazës juridike kompensim shujten ditore, shpenzime të udhëtimit, për shtesën në pagën bazë inflacion dhe kualifikim, sipas padisë paditësja është mësimdhënës në SHFMU”V..F...” në L...dhe e njëjta i plotëson kushtet e përfitimit shujtes ditore, shpenzimeve të udhëtimit, të përqindjes së inflacionit në pagën bazë si dhe kualifikimit, sipas kushteve të parapara më Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë.

E autorizuar e paditëses përmes parashtrësës së datës 08.02.2024 ka bërë precizimin e padisë duke kërkuar nga gjykata që të obligoj të paditurën që t’ia kompensoj paditëses në emër të shpenzimeve të ushqimit për periudhën nga dt.11.03.2019-21.11.2022 për 604 ditë pune aktive shumë prej 1,008€, në emër të shpenzimeve të udhëtimit për periudhën nga dt.10.03.2020-21.11.2022 për 331 ditë pune shumë prej 231.70€, në emër të inflacionit shtesën në pagën bazë për periudhën nga dt.10.05.2020-21.11.2022 shumë prej 715.70€ dhe në emër të kualifikimit diferencën shtesë në pagë bazë prej 27% për periudhën nga dt.11.03.2019-01.02.2023 nga 55.32€ për çdo muaj – për 47 muaj shumë e përgjithëshme prej 2,601.45, të gjitha këto shuma me kamatë si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore që do të shkaktohen .

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditëses e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi. E paditura përmes përgjigjes së saj në padi të parashtruar me datë 01.09.2023, e ka kundërshtuar bazën juridike të kerkespadiisë dhe se sipas nenit 90 pika 5 të Ligjit 03/L212 të Punës në të cilën thirret paditësi, ku thuhet se marrëveshja kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshje të tilla kolektive e që në rastin konkret e paditura Komuna e Lipjanit si punëdhënëse e paditëses nuk është nënshkruese e kësaj marrëveshje-kontratës kolektive në të cilën është thirrur pala paditëse. Poashtu nëse merret parasysh Kontrata Kolektive në nenin 46 par.2 shprehimisht thotë se pagesa e tillë si për kompensimin e ushqimit bëhet brenda mundësive institucionale, ligjore dhe financiare, e që konsideron se nuk janë plotësuar këto kushte, sepse të paditurës nuk i janë ndarë mjete financiare nga institucionet nënshkruese të Kontratës Kolektive. Poashtu sa i përket inflacionit është kompetencë e nivelit qendror e poashtu pika 10 e nenit 35 të Kontratës Kolektive nuk e qartëson se nga kush bëhet përcjellja dhe kush e bënë kompensimin për inflacion. I ka propozuar gjykatës që konform dispozitave ligjore të LK-së nenit 399 par.1 dhe 2 padinë e paditësit ta refuzon si të pabazuar-e pathemeltë.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 152 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se: *“po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim”*, lidhur me nenet 143 dhe 147 të të njëjtit ligj, nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij, dhe ka gjetur se në këtë çështje juridike kontestuese plotësohen kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor.

Nga përgjegje në padi dhënë nga e paditura, gjykata vlerëson se nuk është kontestuese se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditur, mirëpo kontestuese është kompensimin i mjeteve në emër të shpenzimeve të udhëtimit, për shtesën në pagën bazë në bazë të inflacionit dhe shtesës në pagë në emër të kualifikimit për periudhën përkatësisht ditët si në dispozitiv këtij aktgjykimi, andaj nga provat e administruara, si dhe konform dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovës të datës 18.04.2017 dhe ajo në vazhdimësi dt.22.01.2021 e lidhur në mes Ministrisë së Arsimit Shkencë dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe SBASHK-ut, ku me dispoziten e nenit 2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, parashihet se dispozitat e kesaj kontrate kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha insitucionet publike dhe private të Arsimit parauniversitar (para shkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, Shkolla Speciale e Qendra të Kompetencës) dhe Institucione të Arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtar të SBASHK-ut, dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit ne sektorin e arsimit (komunal - DKA, KD te Universiteteve e institucioneve te arsimit te larte, MASHT-in etj) ne sektorin publik dhe institucionet edukativo – arsimore private ne mbarë territorin e Republikës së Kosovës.

Me dispozitën e nenit 35 par.7 të kontratës kolektive të arsimit të Kosovës parashihet *”të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë, ku vlera e kompensimit të shpenzimit për ushqim në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore”*, poashtu me nenin 7 të po kësaj Kontrate parashihet se *“ me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi dhe mbi bazën e kualifikimit, dhe atë: neni 7.3 “ mësimdhënës me diplome 3 dhe 5 vjeqare 27% e pagës bazë, pika 1.4 e po këtij neni, ” mësimdhënës me diplomë 5 vjeqare, magjistraturë/master dhe doktoraturë 35 % e pagës bazë përkatësisht sipas neni 35 par.5 të KKAK-së, parashihet se punëtorët anëtar të SBASHK-ut punonjesit arsimor kompensohen për shpenzimet e udhëtimit prej 70% te çmimit të biletës,*

andaj kjo gjykatë vlerëson se paditëse i takon e drejta e kompensimit për shpenzime të ushqimit për 504 ditë pune shuma prej 1008€ për periudhen nga dt.11.03.201-21.2022( në bazë të vertetimit nr.77/2024 dt.05.02.2024 lëshuar nga SHFMU”V.. F.. në L...”), kompensimi për shpenzime të udhëtimit për 331 ditë pune në shumë prej 231.70€ per periudhen nga dt.10.03.2020-21.11.2022( në bazë të vertetimit nr.31/2021 të lëshuar nga Kompania SHPK “L...” , certifikata e vendbanimit e dt.16.01.2024 lëshuar nga ZGJC Podujeve), përkatësisht për periudhën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Poashtu nga është kontestuese se paditësja është e punësuar tek e paditura, se pagën bazë e ka 421 € (fakt i provuar edhe nga lista e pagës në emër të paditëses) ndërsa se shkalla e inflacionit për vitin 2019 është 2.7%, për vitin 2020 është 0.2 % , për vitin 2021 është 3.4 % dhe për vitin 2022 është 11.6% (fakt i provuar nga llogaritja e shkallës mesatare të inflacionit nga Enti i Statistikave të Kosovës).

Gjykata, duke u mbështetur në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje meritore në këtë çështje juridike kontestimore, pasi provat materiale janë lëshuar nga organi shtetëror – lista e pagave nga ministria përkatëse dhe prova lidhur me shkallën e inflacionit nga Agjencia e Statistikave të Kosovë, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Gjykata ka vlerësuar se në këtë çështje nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor sepse, themelësia e kërkesëpadisë bazën ligjore e ka në dispozitat e nenit 55, par. 1 të Ligjit të Punës, i cili ka përcaktuar se: “I punësuar ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”; nenit 90, par. 5 i cili ka përcaktuar se: “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive” dhe Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021; nenin 35, par. 10 sipas të cilit është përcaktuar: “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”. Dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit e vitit 2017 aplikohen edhe për periudhën Janar 2019– 20.01.2021, ndërsa pas kësaj date ato të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë nr.01B/2056 dhe për Vitin 2021 aplikohen për periudhën 22.01.2021 – 21.11.2022.

Gjykata, pasi gjeti se paditësi i cili është i punësuar tek e paditura nuk është kompensuar për shkallën e inflacionit sipas përqindjes së përcaktuar nga Enti i Statistikave të Kosovës, ndërsa ky kompensim arrin shumat e aprovuara, të cilat janë të llogaritura në bazë të përqindjes për vitin përkatës dhe periudhës kohore të kërkuar për këto vite, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Lidhur me lartësinë e kompensimit sa i përket inflacionit, gjykata ka vendosur duke u bazuar në parashtrësën për precizimin e padisë të autorizuarit të paditësit te dt.14.03.2024, pasi që të njëjtat janë dhënë, e në veçanti duke marr parasysh pagën që paditësi ka realizuar. Për më tepër kalkulimi i këtyre shumave është bazuar në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, ashtu siç përcaktohet edhe në nenin 35 paragrafi 10 të KKAK-së, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditëses i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë :

Për periudhën Prill-Dhjetor 2019 shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, paga bazë e paditëses ka qenë 421.00€ i bie që përqindja e inflacionit është dashur të futej në pagën bazë është 108.41€,

Bazuar në këto të dhëna rezulton se shkalla mesatarja vjetore e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës për vitin 2020 shkalla mesatare e inflacionit ka qenë 0.2%, andaj sa i përket periudhës të vitit 2020 gjykata ia ka njohur paditësit shumën prej 10.70€, si të bazuar pasi që ka marr për bazë pagën bazë në lartësi prej 421.00€ paga x 12muaj = 421.00€ x 0.2% (inflacion) vjetore rezulton shuma prej 10.70€, e cila shumë edhe i është aprovuar.

Për vitin 2021 shkalla mesatare e inflacionit ka qenë 3.4%, andaj sa i përket periudhës të vitit 2021 gjykata ia ka njohur paditëses shumën prej 182.02€, si të bazuar pasi që ka marr për bazë pagën bazë në lartësi prej 421.00€ paga x 12muaj = 5,052.00€ x 3.4% (inflacion) vjetore rezulton shuma prej 171.76€, e cila shumë edhe i është aprovuar.

Për vitin 2022 shkalla mesatare e inflacionit ka qenë 11.6%, andaj sa i përket periudhës të vitit 2022 gjykata ia ka njohur paditëses shumën prej 537.19€, si të bazuar pasi që ka marr për bazë pagën bazë në lartësi prej 421.00€ paga x 11muaj = 4,631€ x 11.6% (inflacion) vjetore rezulton shuma prej 537.19 €, e cila shumë edhe i është aprovuar.

Andaj duke u nisur nga dispozitat ligjore të lart cekura të Kontratave Kolektive, si dhe gjendjes faktike, rezulton që kërkesëpadia e paditësit është e bazuar ku dhe e ka detyruar të paditurën që paditëses t'ia paguaj shumat e specifikuara në pikën I të dispozitivit.

Sa i përket pjesës së kërkesëpadisë që është aprovuar sikurse në pikën I të dispozitivit gjykata e ka marr për bazë pagën bazë ne shumë prej 421 euro, e vertetuar përmes listës së pagave, ku paditësi është i punësuar si mësimdhënës, e jo pagën bruto për faktin se po të ishte marr për bazë paga bruto atëherë kjo pjesë domosdoshmërisht do ti ishte nënshtruar edhe tatimit në pagë siç parashihet me dispozitat ligjore të Ligjit Tatimit në Pagë.

Poashtu me nenin 7 të po këtyre Kontratave parashihet se “ *me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi.*

*Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi dhe mbi bazën e kualifikimit, dhe atë: neni 7.3 “mësimdhënës me diplomë 3 dhe 5 vjeqare 27% e pagës bazë, pika 1.4 e po këtij neni, ” mësimdhënës me diplomë 5 vjeqare, magistraturë/master dhe doktoraturë 35 % e pagës bazë.*

Me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.01/33 të dt.29.08.2008 parashihet se nga 1 Shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësve etj., do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimdhënësve, drejtorëve, zëvendësdrejtorëve dhe bashkëpunëtoreve profesional, me diplomë të shkollës normale 10 % të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike me një ngritje të pagës bazë prej 19%, me diplome universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35 %.

Gjykata ka gjetur se në rastin në fjalë zbatohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.01/33 i datës 29.08.2008, i cili vendim ka qenë në fuqi deri me datë 06.02.2023 ku është shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik numër 08/L-196. Sipas këtij vendimi, në pikën 1 është përcaktuar se: “Nga 1 shtatori të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”, ndërsa pika 4 nën pika 2) e tij, ka përcaktuar se: “Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%”.

Zbatimi i këtij vendimi të Qeverisë dhe rastet e kualifikimit-licencimit, janë në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 214/2023 të datës 05.10.2023.

Gjykata vlerësoi se e paditura nuk ia ka kompensuar paditësit pagën sipas përqindjes për shkak të kualifikimit shkollor, përkatësisht me diplomë të UP-bachelor i biologjisë, pasi është paguar në shumën prej 58.32euro për kualifikim (fakt i provuar nga lista e pagës), ndërsa sipas përqindjes së përcaktuar në Vendimin e Qeverisë, është dashur të paguhet në shumën prej 113.67 euro, (27% e pagës bazë 421.00 euro), me ç'rast i ka mbetur borxh paditëses për çdo muaj në shumën prej 55.32euro dhe atë: 47 muaj x 55.32 € = 2,600.54euro.

Pasi që nga provat e lartcekura u vërtetua se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, e njëjta ka diplomë -3 vjeqare bachelor i biologjisë dhe ka licencë të rregullt dhe lloj të licencës së karrierës, rezulton se konform vendimit të lartcekur, paditëses i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, më konkretisht të pjesës së pa kompensuar lidhur me këtë të drejtë monetare për çdo muaj, për periudhën kohore nga dt.11.03.2019-01.02.2023 për 47 muaj, ashtu që për këtë periudhë paditësit i takon diferenca për çdo muaj nga 55.35 euro.

Lartësinë e kërkesëpadisë së aprovuar gjykata e ka bazuar në precizimin e kërkesëpadisë së paditëses te dt.08.02.2024.

Meqenëse, ashtu siç është rregulluar e paditura ka pasur detyrim të paditësit tia fut në pagë shkallën e inflacionit të cilën gjë nuk e ka bërë për periudhën kontestuese, në njërin anë kurse në anën tjetër edhe paditura nuk e ka përmbushur obligimin siç e ka pasur për detyrim sipas Kontratës Kolektive e datës 18.04.2017, dhe asaj të datës 22.01.2021 sa i përket mjeteve monetare në emër të shkallës së përqindjes së inflacionit dhe nenit 8 të LMD-së, ku thuhet se *“Pjesëmarrësi në marrëdhënie të detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”*, e të cilin detyrim e paditura nuk e ka përmbushur ndaj paditësit.

Poashtu poqëse e paditura e konteston kërkesëpadinë, përgjigja në padi duhet t’i përmbajë edhe faktet mbi të cilat i padituri i mbështetë thëniet e tij dhe provat me të cilat provohen faktet e tilla”, në çështjen konkrete juridike vlerëson se paditura nuk i ka bashkangjitur asnjë provë konkrete parashtrësës së përgjigjes në padi, me të cilat do ti vërtetonte pretendimet e saj.

Andaj, meqenëse në mes palëve ndërgjyqëse nuk ekziston kontest lidhur me faktet relevante, fakte të cilat u vërtetuan edhe nga gjykata me shqyrtimin e provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata me zbatimin e dispozitave të lartpërmendura vendosi aprovimin e kërkesëpadisë së paditëses.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e të autorizuarit të të paditurës lidhur me ate se komuna nuk është nënshkruese e kontratës kolektive se nuk kanë parapara mjete financiare për shlyerjen e këtyre detyrimeve, por gjykata pretendimet e tilla i konsideroi të pa bazuara ngase e paditura lidhur me kompensimin e paraqitur me padi obligohet në bazë të detyrimeve të cilat dalin nga Kontrata Kolektive, nënshkruese e të cilës është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, përkatësisht në nenin 2 par.1.1 të kësaj kontrate lidhur me zbatimin e këtyre dispozitave përcaktohet se *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla special e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”*, ndërsa dispozitat e par.1.2 përcaktohet se *“Dispozitat e e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”* prandaj është edhe irelevante për këtë proces gjyqësor se si e paditura i siguron mjetet për kompensimin e këtyre kategorive, e poashtu sa i përket kundërshtimit të t’paditues se

paditësja me padi a ka kërkuar kompesnimi e shpenzimeve të udhëtimit apo ushqimit, të njejtën e ka precizuar me parashtrësen e dt.08.02.2024.

Gjykata për lartësinë e kamatës në shkallë prej 8%, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 paragrafi 2 i LMD-së, dhe Mendimit Juridik për Kamatat i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 02.12.2020, duke filluar me llogaritjen e kamatës nga dita e paraqitjes së kërkesëpadiisë në këtë gjykatë, e deri në përmbushjen definitive të detyrimeve.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës, iu referua nenit 449 dhe 452 të LPK-së, sipas të cilave paditëses ju pranohen shpenzimet procedurale dhe atë ashtu që e detyroi të paditurën që paditësit t'ia kompensojë në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore shumë prej 104 euro në emër të parashtrimit të padisë, për parashtrësë për precizimin e kërkespadiisë shumë prej 104-€, si dhe shumë prej 30.00 euro në emër të taksës gjyqësore, në total shuma prej 238-€.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan**

**Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil**

**C.nr.688/21 me datën 15.05.2024**

**G j y q t a r i**

**Zenel Tasholli**

**Udhëzim juridik:** Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 7 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate.